

## FJALA E DEPUTETIT FLAMUR NOKA

E ENJTE 10 NËNTOR 2022

Kemi 2 ditë që diskutojmë të famshmin projektbuxhet të bandës në pushtet. Ka një gjë që shqiptarëve u dogji shumë dje, ka një gjë që dje u shkaktoi dhimbje më shumë se ky buxhet: urgjenca me të cilën sulltani i Surrelit kërkoi t'i imponojë këtij Kuvendi, dhe ia imponoi, futjen në rendin e ditës të aferës shumëmiliardëshe të shekullit, të portit të Durrësit. Çdo shqiptar bën pyetjen: “Pse ishte me kaq urgjencë për ta futur? Çfarë kishte urgjente, që duhej të futej pikërisht në ditën e buxhetit?” Sepse ditën e buxhetit e gjithë zurma do të përqendrohej rreth buxhetit dhe do të eklipsohej korrupsioni, megaafëra e shekullit, hajdutëria dhe babëzia e shekullit të kësaj bande, që paturpësisht ka emrin qeveri. Pas kësaj afere fshihen këta këtu mbrapa, Kryeministri dhe banda e tij, se nuk shpjegohet ndryshe pse duhet të ketë përjashtim nga taksat.

Askush nuk tha asnjë fjalë se pse nuk u bë me garë të hapur. A mos është rastësi që miku i Lukashenkos dhe vëllezërit Kariç janë pas kësaj afere? Pse pikërisht aleati kryesor i Putinit dhe mëkëmbësi i tij në Beograd, ka dërguar ushtarët e tij për të qenë pjesë e kësaj afere? Pse Edi Rama zgjodhi pikërisht këta individë? Cila është lidhja? Si në të gjitha aferat, Edi Rama është as më shumë, e as më pak, vetë i tëri i përfshirë në pazar dhe në aferë. Ndaj do të ngelet turp dhe njollë në historinë e këtij parlamenti, që e futi me urgjencë, që mbështeti dhe votoi një megaafërë, ku shqiptarëve u vidhet një nga pronat më të mira të këtij vendi dhe i jepet Kryeministrit, mikut të Lukashekno, ushtarëve të Vuçiçit, e të tjerë.

Të rikthehemi te buxheti.

E dëgjuam Kryeministrin, i dëgjuam edhe të tjerët, që flasin më mburrje për dyfishim të buxhetit. Kur çdo qytetar dëgjon për këtë dyfishim mendon se në kushte normale, një qeveri normale, pas termit “dyfishim buxheti” do të vijnë terma të tjerë, si “dyfishim rrogash”, “dyfishim pensionesh”, “dyfishim i ndihmës ekonomike”, “dyfishim i investimeve” për t'i përmirësuar standardet dhe cilësinë e jetës shoqërisë në tërësi. Por jo, ka vetëm një zë që dyfishohet në këtë të famshmin buxhet të dyfishtë, zëri për tenderët, koncesionet në ajër, sepse qeveria e Edi Ramës ka vendosur të dyfishojë vjedhjen. Nuk ka asgjë në shërbim të qytetarëve dhe e gjithë barra e kësaj krize u kalon qytetarëve. “Shtrengo rripin, Thanas!”, u thotë qytetarëve Edi Rama, asgjë tjetër, asnjë masë në këtë buxhet për të lehtësuar rritjen e

çmimeve. Me këtë buxhet kjo qeveri tregoi edhe një herë që ka një cilësi, që është pashpirtësia dhe pangopësia, asgjë tjetër.

Ky është një buxhet jashtëzakonisht i keq për shqiptarët dhe i mirë për qeveritarët. Pse është i keq për shqiptarët? Sepse vetëm rrit shpenzimet, nuk hap vende pune. Në çdo vend tjetër, kur dyfishohet buxheti, pa as më të voglin diskutim, dyfishohen edhe vendet e punës. Çdo qeveri demokratike dhe jo klikë, kërkon dhe bën gjithçka për të rritur numrin e vendeve të punës, për të ndikuar në mirëqenien e popullit të vet. Jo, këtu parashikohen udhëtime me avionë privatë, luksi qeveritar plot dhe pa fund, kurse xhepat e shqiptarëve mbeten bosh. Kjo është tragjike, sepse ky buxhet fut më pak para në xhepat e shqiptarëve, duke e varfëruar më shumë popullin e gomoneve.

E them me keqardhje që ky është buxheti i gomoneve, i shpopullimit të Shqipërisë. Shkurt dhe shqip, Edi Rama nuk e do këtë vend, ndaj bashkë me bandën e tij harton një buxhet të tillë. Ky është buxheti i gomoneve, për ta shpopulluar Shqipërinë, sepse nga harta e investimeve janë fshirë arsimiti, bujqësia e të gjithë sektorët jetikë të këtij vendi. E thashë, ka vetëm tenderë dhe koncesione në ajër, për të vjedhur më shumë dhe për të blerë më shumë vota nesër.

Nuk ka investime në Policinë e Shtetit.

Më pas do ta marrë fjalën ministri, por ai duhet të thotë pse sot po ikin policët nga puna dhe po u hipin gomoneve, pse oficerët dhe punonjësit e shërbimit ikin, duke braktisur SHIK-un dhe u hipin gomoneve? Sepse u shtrëngon rripin dhe lakun qeveria e Edi Ramës, sepse kemi një Kryeministër tërësisht të pandjeshëm, të shkëputur nga realiteti, i cili as që do t'ia dijë se më shumë se gjysma e popullsisë në këtë vend nuk mbyll dot muajin. Kemi një Kryeministër antishqiptar, sepse ndërkohë që varfëria ka pllakosur këmbëkryq trojet e këtij vendi, ai i jep vetes luksin të investojë për pistat e Formula Uno-s, se Shqipëria dhe shqiptarët janë keq për pistat e Formula Uno-s.

Buxheti i vitit 2023 është një buxhet i papërgjegjshëm, njëllonj si Kryeministri i vendit tonë. Pse e them këtë? Sepse me keqardhje them që në të vërtetë Shqipëria nuk ka Kryeministër, pasi vendin e tij e ka zënë sheiku i Surrelit. Shqipëria sot nuk ka qeveri, por kanë një oborr dhe i bëjnë fresk nga mëngjesi deri në dark sheikut.

Shqipëria me sheikun e Surrelit dhe oborrtarët e tij do të shkojë keq e më keq. Këtë vit do të vazhdojnë të vjedhin dyfish në raport me vjedhjet e viteve të tjera, ndaj shqiptarët do të kenë mundësi që të

shtunën të demostroj në vullnetin e tyre kundër vjedhjes, kundër sheikut dhe oborrtarëve të tij, kundër bandës në pushtet.

Të gjithë shqiptarët janë të ftuar të shtunën në orën 16:00 në sheshin "Skënderbeu". Kjo është një betejë e vështirë, por jo e pamundur me këtë bandë. Ne do të ndalojmë vjedhjen e qeverisë. Të bashkohemi të gjithë të shtunën në orën 16:00, përtej bindjeve politike, për interesin e familjeve tona, për interesin e fëmijëve tanë dhe të ardhmes së tyre, për interesin e Shqipërisë dhe të çdo shqiptari, kudo qofshin.

Të shtunën kemi dy zgjidhje: të ankohe mi kafeneve për bandën e sheikut, ose të derdhemi të gjithë në shesh dhe t'i tregojmë sheikut që ditët e tij në pushtet kanë marrë fund. Tashmë po vjen dita që pushteti t'u kthehet shqiptarëve dhe vetëm shqiptarëve.

Ditën e shtunë, në orën 16:00, duhet të mbli dhemi të gjithë për t'i dhënë leksion këtij sheiku. Faleminderit!